

Akt Themelimi i shoqerise tregtare "ATY" shpk

Sot me date 24.07.2024, z. Eraldo Rexho, shtetas shqiptar, i biri i Fatmirit, i lindur me 07.05.1992, ne Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal J205070570, titullar i 100 % te pjesemarrjes ne kapital, ka themeluar shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ATY" shpk

Neni 1 Themelimi

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "ATY" shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te legjislacionit ne fuqi, aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

Neni 2 Kapitali

Kapitali i shoqerise eshte 100 (njqind) Lekë. Kapitali i shoqerise ndahet ne 1 kuote te zoteruar nga ortakut i vetem i shoqerise z. Eraldo Rexho, zoterues i 1 kuote, te barazvlefshme me 100 leke (njqind), te barabarte me 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise;

Neni 3 Selia e shoqerise

Shoqeria e ka seline ligjore te regjistruar ne adresen: Tirane, Blvd. Deshmoret e Kombit, pranë Piramides, njësia nr. BE8.

Neni 4 Objekti i Veprimtarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetet me objektin e meposhtem:

- Bar, restorant, shërbime katering.
- Shitje me pakice e shumice e artikujve te ndryshem ushqimorë e industrialë.
- Tregti me shumice e pakice te lendëve te para dhe mallrave produkt i gatshem ne pergjithesi, pije alkoolike dhe joalkoolike, duhan, industriale te te gjitha llojeve;
- Përpunim te prodhimeve te tokës dhe detit, magazinim te artikujve te ndryshem.
- Blerje dhe transport malli nga furnitorët ne restorant.
- Organizim i eventeve te korporatave, workshop-eve, panairove, turneve edukative, fushatave te marketingut dhe aktiviteteve artistike e kulturore.
- Çdo veprimtari tjetër te ngjashme ose plotësuese te veprimtarise si me sipër.

Neni 5 Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje peridhe kohore te pakufizuar

Neni 6 Administratore

Administrator i shoqerise do te jete z. Eraldo Rexho, shtetas shqiptar, i biri i Fatmirit, i lindur me 07.05.1992, ne Tirane, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal J205070570.

Administratori i emeruar si me sipër do te ushtroje kete funksion per nje peridhe prej 5 vitesh dhe do te kete te drejtat dhe kompetencat e percaktuara nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi, pa asnje kufizim.

Neni 7 Viti Financiar



Viti financiar i shoqerise fillon me 01.01 te çdo viti dhe perfundon me 31.12 te çdo viti.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbyllet me 31 dhjetor te po atij viti.

Neni 8
Baza ligjore

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 10
Dispozita perfundimtare

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje ne gjuhen shqipe dhe angleze, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise **ATY shpk**.

Ortak i vetem i shoqerise
ATY shpk

Eraldo Rexho

Eraldo Rexho
